

KODI YNE I SJELLJES

Të marrësh vendimet e drejta



MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM (CEO)

Mirë se vini në Kodin tonë të sjelljes (Kodi). Kodi i sjelljes është hartuar për të ndihmuar secilin prej nesh që të marrë vendime të drejta dhe t'ju përmbahet vlerave tona themelore dhe Parimeve tona të Biznesit.

Këto vlera dhe parime janë themeli i shoqërisë sonë. Ato nuk janë opsionale. Çdokush që zgjedh të mos i zbatojë ato ka zgjedhur të mos punojë më për Shell.

Të gjithë ne besojmë se veprimet në mënyrë etike, por bota jonë dhe mjedisi i biznesit janë vazhdimisht në ndryshim. Asnjëherë nuk mund të thuash me siguri se di gjithçka apo se nuk je i rrezikuar.

Kodi, duke theksuar përgjegjësitë tuaja, ju ndihmon të identifikoni rreziqet përkatëse të rolit tuaj. Nëse jeni drejtues kodi përmban një seksion shtesë që ju ndihmon të përmbushni përgjegjësitë tuaja në zbatim të tij. Ju gjithashtu mund të përdorni Verifikimin e Integritetit për t'ju udhëhequr në situata të vështira, të cilat nuk mbulohen në faqet në vazhdim.

Nuk ka rëndësi nëse je drejtues, punonjës apo personel i kontraktuar, unë ju inkurajoj të lexoni dhe të përdorni Kodin tonë për t'ju siguruar se po bëni pjesën tuaj për të mbështetur kulturën etike dhe për të mbrojtur të ardhmen e Shell.

Përkushtimi individual kundrejt etikës dhe përputhshmërisë është diçka mbi të cilën secili nga ne mund të ketë kontroll absolut. Çdo veprim pa 100% pajtueshmëri do të minonte performancën tonë dhe mund të përfshinte kosto të larta, të cilat do të dëmtonin themelin tonë, si dhe reputacionin që kemi fituar me mund. Duke ndjekur këtë Kod, ju ndihmoni që Shell të jetë i besueshëm, konkurrues dhe i përballueshëm ekonomikisht.

Kodin konsideroheni si udhërrëfyesin tuaj që ju ndihmon të rifreskoni njohuritë dhe ju jep këshilla të vlefshme. Mund të njiheni me të papritura - mund të jenë shfaqur rreziqe të reja ose ndoshta mund të zbuloni se ndryshimet në punën tuaj ju kanë ekspozuar ndaj rreziqeve për të cilat nuk keni qenë në dijeni më parë. Mos lejoni që nga mendjelehtësia të rrezikoni të thyni rregullat dhe ta vendosni veten, kolegët tuaj ose Shell-in përpara një rreziku të papranueshëm. Për çdo paqartësi që mund të keni, kërkoni në çdo kohë shpjegime sipas mënyrës së përcaktuar në faqet në vijim ose kontaktoni Zyrën e Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell.

Ju falënderoj për përkushtimin tuaj ndaj etikës dhe përputhshmërisë.



Ben van Beurden
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



SHIKONI
VIDEON E BENIT



PËRMBAJTJA

1.0 HYRJE

- 1.1 Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm (CEO)
- 1.2 Kujt i drejtohet Kodi ynë i Sjelljes?
- 1.3 Vlerat themelore dhe parimet tona të biznesit 1

2.0 PËRGJEGJËSITË TUAJA 2

- 2.1 Përgjegjësitë tuaja individuale 4
- 2.2 Verifikimi juaj i integritetit 5
- 2.3 Kërkoni këshilla dhe flisni hapur 6
- 2.4 Përgjegjësitë e drejtuesit 7

3.0 SJELLJET, NJERËZIT DHE KULTURA JONË 8

- 3.1 Shëndeti, siguria, mbrojtja, mjedisi dhe performanca sociale 10
- 3.2 Të drejtat e njeriut 11
- 3.3 Ngacmimi 12
- 3.4 Shanse të barabarta 14
- 3.5 Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe i komunikimeve elektronike 15
- 3.6 Marrëveshjet në abuzim me informacionin e brendshëm 16
- 3.7 Mbrojtja e asetëve 17

4.0 MENAXHIMI I RREZIKUT QË LIDHET ME INFORMACIONIN DHE KOMUNIKIMIN 18

- 4.1 Privatësia e të dhënave 20
- 4.2 Pronësia intelektuale 22
- 4.3 Menaxhimi i informacionit dhe të dhënave 23
- 4.4 Nxjerrja e informacionit dhe komunikimet e biznesit 24

5.0 MENAXHIMI I RREZIKUT NË MARRËDHËNIET ME PALËT E TRETA DHE ATO NDËRKOMBËTARE 26

- 5.1 Lufta kundër ryshfetit dhe korrupsionit 28
- 5.2 Dhuratat dhe mikpritja 29
- 5.3 Konfliktet e interesit 30
- 5.4 Lufta kundër pastrimit të parave 32
- 5.5 Veprimtaria politike dhe pagesat 33
- 5.6 Ligji i konkurrencës (antimonopol) 34
- 5.7 Përputhshmëria në tregti 35

6.0 PËRFUNDIME 36

- 6.1 Fjalorth 37
- 6.2 Parimet e përgjithshme të biznesit të Shell 38

KUJT I DREJTOHET KODI YNË I SJELLJES?

Ky kod zbatohet për çdo punonjës, drejtor dhe zyrtar në çdo shoqëri të Shell. Personeli i kontraktuar që punon për ndonjë shoqëri të Shell gjithashtu duhet të ndjekë Kodin. Kontraktorëve dhe konsulentëve që janë agjentë të, ose punojnë për llogari të, ose në emër të një shoqërie të Shell (nëpërmjet kontraktimit të jashtëm të shërbimeve, proceseve ose ndonjë veprimtarie të biznesit) duhet të respektojnë kodin, kur veprojnë në emrin tonë.

Kontraktorët dhe konsulentët e pavarur duhet të familjarizohen me Kodin, duke qenë se ai zbatohet për bashkëpunimin e tyre me personelin tonë.


Kur një shoqëri e Shell është caktuar zyrtarisht si operator i një sipërmarrjeje të përbashkët, kjo shoqëri e Shell duhet të zbatojë Kodin për operimin e sipërmarrjes së përbashkët.

SI MUND T'JU NDIHMOJË KODI I SJELLJES?

Në brendësi të tij do të gjeni këshilla praktike për ligjet dhe rregulloret, pritshmëritë dhe udhëzime. Ne gjithashtu ofrojmë këshilla praktike për të zgjeruar burimet e informacionit për t'ju ndihmuar të përdorni gjykimin tuaj më të mirë.

Gjithashtu, do të gjeni pyetjet më të shpeshta për të gjitha temat e kodit nëpërmjet mjetit së ilustruar në faqen në vijim.

RRETH SHELL



Shoqëritë në të cilat Royal Dutch Shell plc zotëron investime në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë janë subjekte të veçanta. Në këtë botim shprehjet “Shell”, “Grup” dhe “Grupi i Shell” ndonjëherë përdoren për lehtësi, aty ku u referohen shoqërive të Shell në përgjithësi. Në të njëjtën mënyrë fjalët “ne”, “neve”, dhe “ynë/jonë” gjithashtu përdoren për shoqëritë e Shell në përgjithësi ose për ata që punojnë për to. Këto shprehje përdoren gjithashtu kur nuk ka asnjë qëllim për të identifikuar shoqëri specifike.

VLERAT THEMELORE DHE PARIMET TONA TË BIZNESIT

Ne në Shell kemi një paketë vlerash themelore, që janë ndershmëria, integriteti dhe respekti për njerëzit. Duke treguar përkushtim ndaj këtyre vlerave gjatë punës sonë, secili prej nesh luan rolin e tij në mbrojtjen dhe rritjen e reputacionit të Shell.

Vlerat tona themelore mbështesin të gjithë punën që ne bëjmë dhe përbëjnë themelin e Kodit të Sjelljes dhe të Parimeve të Përgjithshme të Biznesit të Shell (SGBP), të cilat përmenden në faqen e fundit dhe mund t'i lexoni të plotë në www.shell.com/sGBP. SGBP rregullon mënyrën se si shoqëritë e Shell ushtrojnë aktivitetin dhe parashtron përgjegjësitë tona ndaj aksionarëve, klientëve, punonjësve, partnerëve të biznesit dhe shoqërisë në përgjithësi. Ky Kod Sjelljeje përshkruan sjelljen që Shell pret nga ju dhe atë çka mund të prisni ju nga Shell.

Ne gjykohe mi nga mënyra se si veprojmë. Nëse veprojmë në përputhje me ligjin, SGBP-në dhe Kodin tonë do të mbajmë lart reputacionin tonë. Ne nxisim partnerët tanë të biznesit që të veprojnë sipas SGBP-së ose sipas parimeve të njëjta me të.

Njohja dhe respektimi parimeve dhe vlerave tona themelore do t'ju ndihmojnë të kuptoni dhe të ndiqni Kodin.

PËRSE NA DUHET NJË KOD SJELLJEJE? Për të përshkruar sjelljen që pritet nga punonjësit tanë dhe lidhjen që ata kanë me parimet tona të biznesit dhe vlerat themelore.

Aty ku shikoni ikonën e treguar në të djathtë, mund të gjeni informacion dhe pyetjet dhe përgjigjet që lidhen me secilën temë të Kodit. Nëse keni një lexues kodi QR të instaluar në telefonin tuaj inteligjent, hapni lexuesin dhe drejtoheni kamerën drejt simbolit kryesor, aty do të hapet një faqe uebi ose

një video. Ose shihni <http://www.shell.com/ethicsandcompliance>

Mund të shkarkoni një lexues kodi QR nga dyqani i aplikacioneve në telefonin tuaj inteligjent.



PËRGJEGJËSITË TUAJA

Çfarëdo pozicioni që të keni në Shell, ne presim që ju të angazhoheni për të ndjekur Kodin në punën tuaj të përditshme.

Ky seksion parashtron përgjegjësitë tuaja dhe shërben si udhërrëfyes për vendimmarrjen etike. Ka edhe një seksion ku trajtohen në mënyrë të hollësishme përgjegjësitë e drejtuesit.

Mos harroni - nëse mësoni ose dyshoni se dikush po shkel Kodin, jeni të lutur të flisni.

BRENDA KËTIJ SEKSIONI

2.1 Përgjegjësitë tuaja individuale	4
2.2 Verifikimi juaj i integritetit	5
2.3 Kërkoni këshilla dhe flisni hapur	6
2.4 Përgjegjësitë e drejtuesit	7



“NUK KA RËNDËSI NËSE JE DREJTUES, PUNONJËS OSE PERSONEL I KONTRAKTUAR, PËRKUSHTIMI INDIVIDUAL KUNDREJT ETIKËS DHE PËRPUTSHMËRISË ËSHTË DIÇKA MBI TË CILËN SECILI NGA NE MUND TË KETË KONTROLL ABSOLUT...”

Ben van Beurden, Drejtor i Përgjithshëm



2.1 PËRGJEGJËSITË TUAJA INDIVIDUALE

BËJ GJËNË E DUHUR

Kodi i sjelljes është për ju. Ai përcakton kufijtë brenda të cilëve duhet të punojë çdo ditë personeli i Shell, pa përjashtim. Lexojeni. Kuptojeni. Ndiqeni.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ↳ Të kuptoni rreziqet që përfshin pozicioni juaj dhe mënyrën se si t'i menaxhoni ato.
- ↳ Të kërkonti këshilla kur keni gjëra të paqarta.
- ↳ Të kryeni menjëherë trajnimin mbi etikën dhe përputhshmërinë që është caktuar për ju.
- ↳ Të siguroheni se çdo kontraktor palë e tretë, agjentët ose konsulentët me të cilët punoni të jenë në dijeni se ne jemi të detyruar të zbatojmë kodin dhe ata duhet gjithashtu të veprojnë në zbatim të tij.
- ↳ Flisni hapur. E keni për detyrë të raportoni çdo dyshim për shkelje të Kodit.

ÇFARË NDODH NËSE UNË SHKEL KODIN? Shkeljet e

Kodit dhe të politikave përkatëse, mund të çojë në marrjen e masave disiplinore, duke përfshirë edhe shkarkimin nga puna. Në disa raste Shell mund ta raportojë shkeljen tek autoritetet përkatëse, gjë e cila mund të çojë në marrjen e masave ligjore, vënien e gjobave ose burgim.

QENDËR INFORMIMI

Për informacione, trajnime dhe kontakte për këshilla mbi etikën dhe përputhshmërinë vizitoni <http://sww.shell.com/ethicsandcompliance>



Raporto një shqetësim – linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu>)

Kodi ynë i Sjelljes nuk mund t'ju japë këshilla specifike për çdo situatë, vështirësi ose vendim. Analizimi i pyetjeve të Verifikimit të Integritetit do t'ju ndihmojë ju dhe ekipin tuaj në situata të vështira që mund të hasni në lidhje me Kodin e Sjelljes.

Sigurisht që mund t'i drejtoheni për ndihmë menaxherit tuaj të linjës, Zyrës së Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell, Burimeve Njerëzore, Departamentit Juridik të Shell ose linjës telefonike të ndihmës në të gjithë botën.



KUR KENI DYSHIME PYESNI VETEN...



A PO I RESPEKTOJ VLERAT TONA THEMELORE TË “NDRERSHMËRISË, INTEGRITETIT DHE RESPEKTIT PËR NJERËZIT”?



KËRKONI KËSHILLA



KJO QË PO BËJ, A ËSHTË ETIKE DHE NË PAJTIM ME SGBP-në, KODIN TONË TË SJELLJES DHE MANUALET MBËSHTETËSE?



KËRKONI KËSHILLA



A ËSHTË E LIGJSHME DHE A JAM I AUTORIZUAR TA BËJ DIÇKA TË TILLË?



KËRKONI KËSHILLA



A E KAM KUPTUAR MIRË POTENCIALIN PËR RREZIQË, DUKE PËRFSHIRË RREZIQET PËR REPUTACIONIN E SHELL?



KËRKONI KËSHILLA



A ËSHTË GJËJA E DUHUR PËR T'U BËRË DHE A PO JAP NJË SHEMBULL TË MIRË?



KËRKONI KËSHILLA



NËSE KJO BËHET PUBLIKE, A DO TË VAZHDOJ TË MENDOJ SE KAM BËRË GJËNË E DUHUR?



KËRKONI KËSHILLA

2.3 KËRKONI KËSHILLA DHE FLISNI HAPUR

Nëse doni të këshilloheni për ndonjë çështje që lidhet me Kodin ose dëshironi të raportoni një shqetësim, flisni me menaxherin e linjës, Zyrën e Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell, një përfaqësues të Departamentit të Burimeve Njerëzore ose të Departamentit Juridik të Shell. Ose mund të kontaktoni me linjën telefonike të ndihmës në të gjithë botën. Ajo është e disponueshme 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, nëpërmjet një numri telefoni në çdo shtet dhe nëpërmjet internetit dhe stafi i saj është palë e tretë e pavarur. Nëse dëshironi, mund të telefononi ose të dërgoni një raport në mënyrë anonime.

Nëse mësoni ose dyshoni se dikush po shkel kodin, ju e keni për detyrë të raportoni. Nëse zgjidhni të heshtni, rrezikoni reputacionin e Shell dhe penalitete financiare që do të dëmtonin themelin e Shell. Raportimi i një shqetësimi gjithashtu i jep Shell mundësinë që të zbulojë që herët një shkelje të mundshme ose reale të Kodit tonë.

Shell nuk toleron asnjë formë hakmarrjeje kundër ndokujt që ngre një shqetësim në mirëbesim për një shkelje të mundshme të Kodit. Në fakt çdo akt ose kërcënim për hakmarrje kundër personelit të Shell do të trajtohet si shkelje e rëndë e Kodit tonë.

Vizitoni http://www.shell.com/ethicsandcompliance/report_concerns/global_helpline.html për më shumë hollësi.

Për të kontaktuar me linjën telefonike të ndihmës në të gjithë botën, vizitoni <https://shell.alertline.eu/>.

Në disa shtete mund të ketë problem për t'u lidhur me një numër lokal pa pagesë nga celulari ose kabina telefonike publike. Nëse hasni një problem të tillë, keni në dispozicion edhe numrin nga Shtetet e Bashkuara +1 704 973 0344, për të cilin telefonata i faturohet pritësit.

Ne mbështetemi tek drejtuesit tanë që ata të promovojnë standardet tona etike dhe të shërbejnë si shembull për ekipet e tyre. Ndaj ne presim që drejtuesit të jenë udhëheqës në ndjekjen e Kodit tonë dhe të ruajnë kulturën e angazhimit ndaj etikës dhe përputhshmërisë, ku është normale që të bëhet gjëja e duhur dhe njerëzit të mos hezitojnë të flasin hapur.

SI DREJTUES JU DUHET:

- 📖 Të kuptoni dhe të ndiqni Kodin.
- 📖 Të kuptoni rreziqet kryesore të shkeljes së Kodit që gjejnë zbatim për biznesin ose funksionin tuaj dhe procedurat për zbutjen e tyre.
- 📖 Të siguroheni që personeli juaj të gjejë kohën për të ndjekur në mënyrë të menjëhershme trajnimin për etikën dhe përputhshmërinë që është caktuar për ta.
- 📖 Të siguroheni që personeli juaj kupton procedurat që duhet të ndjekë për të shmangur shkeljen e Kodit, duke përfshirë regjistrimin e dhuratave dhe mikpritjes dhe konfliktet e mundshme të interesit në regjistrin e Kodit të Sjelljes.
- 📖 Të siguroheni se çdo anëtar i ri i ekipit të informohet menjëherë për Kodin tonë të Sjelljes, rreziqet për Kodin që lidhen me pozicionin e tij si edhe ku mund të kërkojnë këshilla dhe mbështetje.
- 📖 Të tregoni kujdes për çdo shkelje të Kodit dhe të nxitni anëtarët e ekipit tuaj që të flasin kur mësojnë apo dyshojnë për ndonjë shkelje.
- 📖 Nëse ju njoftojnë për një shkelje të mundshme të Kodit, ju e keni për detyrë të raportoni. Ju mund ta referoni atë në Zyrën e Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell, Departamentin e Burimeve Njerëzore, Departamentin Juridik të Shell ose linjën telefonike të ndihmës në të gjithë botën. Ju, gjithashtu, duhet të siguroheni për ruajtjen e konfidencialitetit për çdo shqetësim të raportuar. Mos e merrni kurrë përsipër për ta hetuar çështjen vetë.
- 📖 Vendosni dhe zbatoni një menaxhim të përshtatshëm të pasojave në përgjigje të një shkeljeje të Kodit.

SJELLJET, NJERËZIT DHE KULTURA JONË

Ne duam që Shell të jetë një vend i mrekullueshëm pune dhe duam të mbrojmë reputacionin që kemi te klientët, furnizuesit, qeveritë dhe komunitetet si një shoqëri që gjithmonë përpiqet të bëjë gjënë e duhur. Për ta bërë këtë, ne kemi nevojë që të gjithë ata që bëjnë biznes në emër të Shell të respektojnë vlerat tona themelore të ndershmërisë, integritetit dhe respektit për njerëzit.

Në këtë seksion të Kodit tonë të Sjelljes parashtrohen standardet e sjelljes së mirë që ne presim prej jush dhe që ju keni të drejtë të prisni prej kolegëve tuaj.

Mos harroni - nëse mësoni ose dyshoni se dikush po shkel Kodin, jeni të lutur të flisni.

BRENDA KËTIJ SEKSIONI

3.1	Shëndeti, siguria, mbrojtja, mjedisi dhe performanca sociale	10
3.2	Të drejtat e njeriut	11
3.3	Ngacmimi	12
3.4	Shanse të barabarta	14
3.5	Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe i komunikimeve elektronike	15
3.6	Marrëveshjet në abuzim me informacionin e brendshëm	16
3.7	Mbrojtja e asetëve	17



“KODI YNË I SJELLJES ËSHTË HARTUAR PËR TË NDIHMUAR SECILIN PREJ NESH QË TË MARRË VENDIME TË DREJTA DHE T’U PËRMBAHET VLERAVE TONA THEMELORE DHE PARIMEVE TONA...UNË JU INKURAJOJ QË TË SIGUROHENI SE PO BËNI PJESËN TUAJ PËR TË MBROJTUR TË ARDHMEN E SHELL.”

Ben van Beurden, Drejtor i Përgjithshëm



Shell po ndihmon në përmbushjen e nevojës në rritje për energji në mbarë botën, dhe po e bën këtë në mënyrë të përgjegjshme për sa i përket aspektit ekonomik, mjedisor dhe social.

Qëllimi ynë është që të arrijmë Objektivin Zero, që do të thotë zero dëmtime dhe zero rrjedhje. Ne jemi të përkushtuar ndaj objektivit për të mos dëmtuar njerëzit dhe për të mbrojtur mjedisin ndërkohë që zhvillojmë burime energjie, produkte dhe shërbime në një mënyrë që përputhet me këto objektiva.

Qëllimi ynë është të fitojmë besimin e klientëve dhe aksionarëve tanë si edhe të kontribuojmë në komunitetet ku ushtrojmë aktivitetin, duke u sjellë si fqinj të mirë dhe duke krijuar përfitime sociale që zgjasin.

Çdo shoqëri, kontraktor dhe sipërmarrje e përbashkët e Shell, nën kontrollin operacional të Shell, duhet të ketë një qasje sistematike për menaxhimin e Shëndetit, Sigurisë, Mbrojtjes dhe Performancës Mjedisore dhe Sociale (HSSE & SP), e projektuar për të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe për të arritur përmirësimin e vazhdueshëm të performancës, ndërkohë që promovohet një kulturë sipas së cilës i gjithë stafi dhe kontraktorët e Shell angazhohen bashkërisht në këtë drejtim. Çdo shoqëri e Shell pritet të përcaktojë objektivat për përmirësimin e HSSE & SP dhe të masë, vlerësojë dhe raportojë nivelet e performancës.

Kuadri i kontrollit të HSSE & SP i Shell mbështet zbatimin efektiv dhe eficient të Angazhimit dhe Politikës sonë për HSSE & SP në të gjithë Grupin e Shell. Kjo është mënyra se si ne i menaxhojmë ndikimet e operacioneve dhe projekteve tona në shoqëri dhe në mjedis.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

↳ Duhet të ndiqni tre Rregulla të Arta:

- (i) **Respektoni** ligjin, standardet dhe procedurat
- (ii) **Ndërhyni** në situata pasigurie dhe mospërputhjeje
- (iii) **Respektoni** fqinjët tanë.

↳ Duhet të siguroheni që puna juaj të jetë në përputhje me Angazhimin dhe Politikën e HSSE & SP.

↳ Duhet të respektoni 12 Rregullat për Shpëtimin e Jetës.

↳ Duhet të raportoni dhe të veproni kundrejt një incidenti, incidenti të mundshëm apo incidenti të shmangur në lidhje me HSSE & SP menjëherë sapo të merrni dijeni.

QENDËR INFORMIMI



Angazhimin dhe Politikën e HSSE & SP, Rregullat për Shpëtimin e Jetës dhe manualin e Kuadrit të Kontrollit të HSSE & SP të Shell mund t'i gjeni në <http://sww.shell.com/ethicsandcompliance/hsse>

Raportoni incidentet e HSSE & SP në - <http://sww.shell.com/hse/it/fim/input.html>

Raporto një shqetësim – linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu>)

Kryerja e veprimtarive tona në respektim të të drejtave të njeriut është një domosdoshmëri për biznesin e Shell dhe madje mbështet licencën tonë për të operuar. Kërkesat për të drejtat e njeriut janë të mishëruara në kuadrin, manualët dhe politikat tona ekzistuese dhe ato përfshijnë:

- ↳ Performanca sociale. Të gjitha projektet dhe objektet e mëdha duhet të jenë të pajisura me një plan për performancën sociale dhe të trajtojnë ndikimet sociale të operacioneve tona në komunitetet lokale.
- ↳ Siguria. Kërkesat për sigurinë në të gjithë shoqërinë ndihmojnë për të ruajtur sigurinë e stafit, kontraktorëve dhe ambienteve, në mënyrë të tillë që respekton të drejtat e njeriut dhe sigurinë e komuniteteve lokale.
- ↳ Burimet njerëzore. Politikat dhe standardet tona na ndihmojnë të krijojmë praktika pune të drejta dhe një mjedis pozitiv pune.
- ↳ Kontraktimet dhe prokurimet. Ne kërkojmë të punojmë me kontraktorë dhe furnizues të cilët kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të cilët janë të përgjegjshëm në aspektin ekonomik, mjedisor dhe social.

Ne respektojmë legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme duke përfshirë edhe Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe konventat kryesore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Gjithashtu ne bashkëpunojmë rregullisht me palët e jashtme të interesuara dhe gjithmonë përipiqemi të kontribuojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jodirekte, për të mirën e përgjithshme të komuniteteve ku operojmë.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ↳ Duhet të siguroheni që puna juaj të jetë në përputhje me angazhimet e Shell për të drejtat e njeriut në Performancën Sociale, Sigurinë, Burimet Njerëzore dhe Kontraktimet e Prokurimet.
- ↳ Nëse mësoni apo dyshoni për ndonjë shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut në lidhje me biznesin tonë, është detyra juaj të flisni.

QENDËR INFORMIMI



Politikat e Shell në lidhje me të drejtat e njeriut dhe në lidhje me rolin tuaj për menaxhimin e të drejtave të njeriut i gjeni në <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/humanrights>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Shell nuk do të tolerojë asnjë ngacmim. Ne nuk do të tolerojmë asnjë veprim apo sjellje poshtëruese, frikësuese apo armiqësore. Trajtoji të tjerët me respekt dhe shmangni situatat që mund të duken si të papërshtatshme.

Opinionet, kritikata dhe kundërshtimet duhet të transmetohen gjithmonë në mënyrën e duhur dhe duke treguar respekt. Veçanërisht, kushtojini vëmendje ndjeshmërisë kulturore - çfarë është e pranueshme në një kulturë mund të mos jetë e tillë në një tjetër. Është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm dhe t'i kuptoni këto dallime.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ↳ Gjithmonë duhet t'i trajtoni të tjerët me respekt.
- ↳ Nuk duhet t'i frikësoni apo t'i poshtëroni të tjerët fizikisht apo me fjalë.
- ↳ Nuk duhet të bëni shaka apo komente të papërshtatshme.
- ↳ Nuk duhet të shpërndani materiale fyese apo mos respektuese.
- ↳ Mund të kundërshtoni dikë nëse sjellja e tyre ju duket armiqësore, frikësuese, poshtëruese apo jorespektuese. Mund të kontaktoni gjithmonë me menaxherin tuaj të linjës, Zyrën e Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell, Burimet Njerëzore, Departamentin Juridik të Shell ose linjën telefonike të ndihmës në të gjithë botën.

QENDËR INFORMIMI



Për më shumë informacion për diversitetin dhe përfshirjen vizitoni <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/harassment>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Pyetje

Mbikëqyrësi im i bën shumë nga ne të ndihen keq me shakatë dhe komentet e tij të pasjellshme. Çfarë duhet të bëj?

Përgjigje

Flisni me mbikëqyrësin tuaj për mënyrën se si ndiheni. Nëse nuk ndiheni komod që të flisni drejtpërdrejt me mbikëqyrësin tuaj, mund të flisni me një menaxher tjetër, me Zyrën e Shell për Etikën dhe Përputhshmërinë, me Burimet Njerëzore ose të telefononi linjën telefonike të ndihmës në të gjithë botën. Nuk do të tolerohet asnjë ngacim apo mjedis armiqësor pune ku punonjësit të ndihen të kërcënuar apo të frikësuar.



3.4 SHANSE TË BARABARTA

Në Shell ne ofrojmë shanse të barabarta për këdo. Kjo na ndihmon të sigurohemi që gjithmonë të tërheqim një grup sa më të gjerë të mundshëm talentesh dhe të tërheqim njerëzit më të mirë. Ne mbështetemi te i gjithë stafi i Shell për të ruajtur nivelin e shanseve të barabarta.

Ndonjëherë, njerëzit pa e kuptuar mund t'i shkelin politikat për shanse të barabarta - për shembull, kur në mënyrë të pavetëdijshme tregohen të njëanshëm në rekrutimin e njerëzve të ngjashëm me vetë ata. Prandaj, gjithmonë duhet të përpiqeni të jeni objektivë dhe të siguroheni që perceptimet tuaja personale, paragjykimet dhe preferencat të mos ndikojnë në vendimet tuaja lidhur me punësimin. Gjithashtu, duhet të keni njohuri për legjislacionin vendas që mund të ndikojë në vendimet e punësimit.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ↳ Kur merrni vendime për punësimin, duke përfshirë punësimin, vlerësimin, promovimin, trajnimin, zhvillimin, disiplinën, shpërblimin dhe zgjidhjen e kontratës së punës, duhet të bazoheni vetëm në faktorë objektivë, duke përfshirë meritat, kualifikimet, performancën dhe rrethanat e biznesit.
- ↳ Duhet të kuptoni vlerën e diversitetit dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të bëni diskriminime në bazë të racës, ngjyrës, fesë, moshës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, gjendjes civile, aftësive të kufizuara, originës etnike apo kombësisë.

QENDËR INFORMIMI



Për më shumë informacion rreth njëanshmërisë së pavetëdijshme vizitoni <http://sww.shell.com/ethicsandcompliance/eo>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Shell ju furnizon me pajisje IT dhe komunikime elektronike që ju të mund të kryeni punën tuaj në mënyrë të sigurt dhe të rregullt. Përgjegjësitë tuaja për përdorimin e pajisjeve IT dhe komunikimeve elektronike përcaktohen më poshtë.

Pajisjet IT dhe komunikimet elektronike përfshijnë harduerët, softuerët dhe të gjitha të dhënat që përpunohen duke i përdorur ato. Këtu mund të përfshihen pajisjet tuaj personale IT ("Sill Pajisjen Tënde Personale"), kur këto pajisje janë autorizuar për përdorim për punë nga menaxheri juaj i linjës.

Shell regjistron dhe monitoron përdorimin e pajisjeve të saj IT dhe të çdo pajisje tjetër të lidhur përmes rrjetit të Shell.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ⌘ Duhet të respektoni kërkesat për sigurinë e IT të Shell.
- ⌘ Nuk duhet të përdorni llogari personale emaili për komunikimet e punës, përveç rastit kur jeni autorizuar nga menaxheri juaj i linjës.

- ⌘ Nuk duhet t'u jepni të tjerëve kredencialet e identifikimit elektronik në Shell.
- ⌘ Nuk duhet të ndryshoni apo çaktivizoni konfigurimet e sigurisë apo konfigurime të tjera të shkarkuara nga Shell në pajisjen tuaj personale IT, përveç rastit kur jeni udhëzuar nga Shell për këtë.
- ⌘ Duhet që pajisjet IT dhe komunikimet elektronike të Shell t'i përdorni personalisht, gjithashtu mediat sociale t'i përdorni rrallë dhe shkurt e të mos përdorni emrin apo markën e Shell në emaile personale.
- ⌘ Nëse keni një telefon celular të punës, duhet të respektoni politikën për një përdorim të pranueshëm.
- ⌘ Nuk duhet të hyni, ruani, dërgoni apo të postoni pornografi apo materiale të tjera të pahijshme ose fyese kur përdorni mjetet e komunikimit apo pajisjet IT të Shell dhe as nuk duhet të lidheni me faqet online të lojërave të fatit apo të kryeni veprimtari të paligjshme.
- ⌘ Nuk duhet të ruani apo të dërgoni fotografi ose imazhe mediatike (në rrjet) apo të shkaktoni në ndonjë formë tjetër trafik në rrjet apo kosto për ruajtjen e të dhënave për shkak të përdorimit personal.
- ⌘ Nuk duhet të kryeni veprimtaritë tuaja personale të biznesit duke përdorur mjetet e komunikimit apo pajisjet IT të Shell, apo të mbështesni të tjerët që të veprojnë në këtë mënyrë.
- ⌘ Duhet të përdorni vetëm shërbime në internet që janë të miratuara (qofshin ato tregtare, për konsumatorin apo të ofruara falas) për të ruajtur, përpunuar apo për të dhënë informacion për biznesin, siç përcaktohet në rregullat e Grupit.

QENDËR INFORMIMI



Për politikën për telefonat celularë, udhëzimet për mediat sociale dhe për më shumë hollësitë për administrimin e rrezikut të informacionit vizitoni <http://sw.shell.com/ethicsandcompliance/useofit>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Në Shell, ne respektojmë legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar për marrëveshjet në abuzim me informacionin e brendshëm (p.sh. tregtimin e aksioneve apo të titujve të tjerë kur disponon informacion të brendshëm për një shoqëri). Informacioni i brendshëm është informacioni brenda Grupit, i cili është preciz, nuk është bërë publik dhe që, nëse nxirret me shumë gjasa do të kishte një efekt të konsiderueshëm në çmimin e aksioneve të tregut apo në titujt e tjerë të Royal Dutch Shell plc apo të ndonjë shoqërie tjetër të listuar. Marrëveshjet që bazohen në abuzimin me informacionin e brendshëm përfshijnë tregtinë e drejtpërdrejtë në tituj si dhe përcjelljen e informacionit të brendshëm një personi tjetër që e përdor atë informacion të brendshëm për të tregtuar aksione apo tituj të tjerë. Marrëveshjet në abuzim me informacionin e brendshëm janë të paligjshme dhe të padrejta.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- Nuk duhet të nxirrni asnjë informacion të brendshëm rreth Royal Dutch Shell plc, përveçse kur autorizoheni për ta bërë këtë.
- Nuk duhet të tregtoni tituj të Royal Dutch Shell plc kur keni informacion të brendshëm.
- Nëse bëni pjesë në Listën e Nëpunësve që kanë Informacion të Brendshëm, nuk duhet të bëni tregti pa autorizim paraprak.
- Nëse gjatë rrjedhës së punës ju bie në dorë informacion i brendshëm për ndonjë shoqëri tjetër të listuar, nuk duhet të bëni tregti me aksionet dhe titujt e asaj shoqërie deri në momentin kur çdo lloj informacioni i brendshëm të jetë bërë publik. Gjithashtu, nuk duhet t'i jepni askujt informacion nëse nuk jeni autorizuar për ta bërë këtë.

QENDËR INFORMIMI



Për më shumë informacion mbi marrëveshjet në abuzim me informacionin e brendshëm vizitoni <http://sww.shell.com/ethicsandcompliance/harassment>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Asetet e Shell janë në shumë forma të ndryshme - fizike, elektronike, financiare dhe të patrupëzuara. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për një laptop të Shell, për markën tonë apo qoftë edhe për një ambient apo ndërtesë, ne presim nga të gjithë që të kujdesen për asetet tona.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ℞ Ju jeni personalisht përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e duhur të asetëve të Shell. Duhet ta mbroni Shell kundër mbetjeve, humbjeve, dëmeve, abuzimeve, mashtrimeve, vjedhjeve, shpërdorimeve, shkeljeve dhe formave të tjera të keqpërdorimit dhe po kështu të mos bëheni pjesë e tyre.
- ℞ Duhet të mbroni pasurinë e shoqërisë që ju është lënë në mirëbesim dhe të jepni kontributin tuaj për mbrojtjen e asetëve të përbashkëta të Shell kundër humbjes apo keqpërdorimit. Të jeni vigjilent për rrezikun ndaj vjedhjeve.
- ℞ Nuk duhet të fshihni, ndryshoni apo të shkatërroni dokumente në mënyrë të paligjshme.
- ℞ Duhet të përdorni vetëm kartën e kreditit të korporatës për shpenzime pune të arsyeshme dhe të miratuara dhe nuk duhet ta përdorni atë për blerje të artikujve që bëjnë pjesë në kategoritë e ndaluara.
- ℞ Gjithashtu, duhet të jepni kontributin tuaj për mbrojtjen e asetëve të përbashkëta të Shell - siç mund të jetë një fotokopje apo deri te një ndërtesë. Edhe pse nuk jeni personalisht përgjegjës për këto, duhet të jepni ndihmën tuaj për t'u kujdesur për to dhe, nëse dikush tjetër i vë ato në rrezik dhe nuk i përdor siç duhet, duhet të ndërhyni dhe të raportoni problemin.

QENDËR INFORMIMI



Për Politikën për Kartën Globale të Korporatës dhe listën e kategorive të ndaluara vizitoni <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/poa>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

- ℞ Duhet të respektoni asetet e të tjerëve.

MENAXHIMI I RREZIKUT QË LIDHET ME INFORMACIONIN DHE KOMUNIKIMIN

Puna jonë për Shell varet nga përdorimi dhe shkëmbimi i informacionit. Gjatë punës sonë të përditshme, të gjithë kemi të bëjmë me informacione dhe komunikojmë në mënyra të ndryshme, dhe duhet të marrim në konsideratë rreziqet që lidhen me këto veprimtari. Këtu përfshihet rreziku që të dhënat personale apo të dhënat për Pronësinë Intelektuale të Shell të mund të bien të duart e gabuara. Komunikimi pa kujdes apo dhënia e informacionit të paautorizuar mund të dëmtojë reputacionin tonë apo të çojë në marrjen e masave ligjore. Ky seksion i Kodit të Sjelljes parashikon trajtimin e këtij lloji rreziku.

Mos harroni - nëse mësoni ose dyshoni se dikush po shkel Kodin, jeni të lutur të flisni.

BRENDA KËTIJ SEKSIONI

4.1	Privatësia e të Dhënave	20
4.2	Pronësia intelektuale	22
4.3	Menaxhimi i informacionit dhe të dhënave	23
4.4	Nxjerrja e informacionit dhe komunikimet e biznesit	24



**“KODIN KONSIDEROJENI SI
UDHËRRËFYESIN TUAJ... MUND TË
GJENI GJËRA TË PAPRITURA - MUND
TË JENË SHFAQUR RREZIQE TË REJA
OSE NDOHTA MUND TË ZBULONI SE
NDRYSHIMET NË PUNËN TUAJ JU
KANË EKSPOZUAR NDAJ RREZIQEVE
PËR TË CILAT KENI QENË NË DIJENI MË
PARË.”**

Ben van Beurden, Drejtor i
Përgjithshëm



4.1 PRIVATËSIA E TË DHËNAVE

Legjislatiioni për privatësinë e të dhënave mbron informacionin rreth individëve - të dhënat e tyre personale. Shell respekton të drejtat e privatësisë së stafit të tij, klientëve, furnizuesve dhe partnerëve të biznesit. Ne përkushtohemi të menaxhojmë të dhënat personale në mënyrë profesionale, të ligjshme dhe etike.

Të dhënat personale përkufizohen gjerësisht si çdo lloj informacioni që lidhet me një individ të identifikuar apo të identifikueshëm, si p.sh. emri dhe të dhënat e kontaktit. Informacione që janë më private, si për shembull raca apo origjina etnike, të dhënat shëndetësore, orientimi seksual, sjelljet kriminale apo anëtarësimi në ndonjë sindikatë konsiderohen si të dhëna personale sensitive dhe janë objekt i kërkesave më të rrepta.

Ne mund të përpunojmë të dhëna personale vetëm për qëllime të ligjshme dhe këto të dhëna duhet të jenë të sakta dhe të përshtatshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur, si dhe duhet të mbrohen siç duhet ndaj aksesit të paautorizuar apo keqpërdorimit. Kur këto të dhëna duhet t'u transferohen palëve të treta, ato duhet të mbrohen siç duhet. Nëse nuk i respektojmë këto kërkesa, rrezikojmë që t'u shkaktojmë dëm

individëve, mund të marrim urdhër për të ndërprerë përpunimin e këtyre të dhënave dhe mund të përballemi me gjopa apo çështje gjyqësore. Po kështu vëmë në rrezik edhe reputacionin e Shell.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- Duhet të identifikoni rreziqet e privatësisë përpara se të grumbulloni, përdorni, ruani apo jepni të dhëna personale, si për shembull një sistem i ri IT, projekt apo iniciativë marketingu.
- Duhet të përpunoni të dhëna personale vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara dhe të ligjshme.
- Kur të përpunoni apo jepni të dhëna personale të individëve, gjithmonë duhet t'i njoftoni ata. Në raste të caktuara do duhet edhe të merrni pëlqimin e tyre paraprak.
 - Gjithmonë duhet t'i mbronni të dhënat personale nëse i ndani me një palë të tretë. Kur nuk jeni të sigurt nëse duhet të merrni pëlqimin e tyre apo se si të mbronni të dhënat personale kur i ndani ato me një palë të tretë, gjithmonë konsultohuni me Departamentin Juridik në Shell apo me Zyrën e Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell.
- Duhet të siguroheni që të dhënat personale që dispononi të mbahen të përditësuara dhe të asgjësohen kur nuk nevojiten më.

QENDËR INFORMIMI



Për Manualin për Privatësinë e të Dhënave, Rregullat për Privatësinë e të Dhënave dhe Kontaktet për Privatësinë e të Dhënave vizitoni <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/dp>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Pyetje

Një mikeshë ime më kërkoi që t'i jepja të dhënat e kontaktit të kolegëve të mi për t'i vendosur në listën e saj të adresave për punë. Mendoj se kolegëve do t'u pëlqenin ato që ajo shet dhe gjithashtu unë dëshiroj ta ndihmoj atë. A mund të vazhdoj dhe t'i jap asaj emrat dhe adresat e tyre të email?

Përgjigje

Jo – mikeshë juaj duhet të gjejë një mënyrë tjetër për të ndërtuar bazën e të dhënave të klientëve të saj. Mund të përpunoni të dhëna personale vetëm për qëllime të ligjshme të biznesit të Shell.



4.2 PRONËSIA INTELEKTUALE

Shell disponon marka, ide dhe teknologji shumë të mira, të cilat na kanë falur një reputacion shumë të mirë që të gjithë ne duhet ta mbrojmë.

Gjithashtu këto marka, ide dhe teknologji kaq të vlefshme kanë nevojë për mbrojtje, njëlloj si markat tregtare, patentat, ekspertiza, sekretet tregtare dhe të drejtat e tjera të Pronësisë Intellectuale, dhe duhet të përdoren në mënyrë optimale për Shell.

Është po aq e rëndësishme që të respektojmë dhe të shmangim shkeljet e të drejtave të Pronësisë Intellectuale të të tjerëve. Nëse nuk e bëjmë, rrezikojmë të dëmtojmë biznesin dhe reputacionin tonë dhe kjo mund të ndikojë në kapacitetet apo licencën tonë për të operuar.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ↳ Duhet të përdorni siç duhet markat dhe markat tregtare të Shell, duke respektuar Standardet për Markat.
- ↳ Duhet të raportoni rrisitë dhe shpikjet tuaja në Departamentin Juridik të Pronësisë Intellectuale në Shell.
- ↳ Duhet të klasifikoni dhe ruani siç duhet informacionin teknik dhe atë të biznesit të Shell, bashkë me kontrollet e duhura të aksesit.
- ↳ Nuk duhet të nxirrni informacionin konfidencial të Shell jashtë Grupit të Shell pa leje ose pa një marrëveshje përkatëse me shkrim dhe duhet të ruani të dhënat për informacionin që jepni sipas marrëveshjes.
- ↳ Nuk duhet të pranoni informacion konfidencial nga një palë e tretë nëse nuk keni leje për ta pranuar dhe nëse nuk keni rënë dakord ta pranoni sipas një marrëveshjeje paraprake me shkrim.
- ↳ Nuk duhet të keqpërdorni informacionin konfidencial të një pale të tretë. Nëse përgjegjësia juaj është të prezantoni marka të reja në një treg apo teknologji të reja pronësore, së pari duhet të konsultoheni me Departamentin Juridik të Pronësisë Intellectuale në Shell për të ulur rrezikun që Shell të shkelë të drejtat e Pronësisë Intellectuale të të tjerëve.
- ↳ Nëse vini re se një palë e tretë ka shkelur apo ka keqpërdorur të drejtat e Pronësisë Intellectuale të Shell, për shembull duke përcjellë dokumente që përmbajnë informacion konfidencial, është detyra juaj të flisni.

QENDËR INFORMIMI



Për Standardet dhe Kuadrin e Pronësisë Intellectuale, Standardet për Markat dhe Kontaktet e Pronësisë Intellectuale vizitoni <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/ip>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Si të gjitha organizatat ne varemi nga përdorimi dhe shkëmbimi i informacionit për vendimet tona të biznesit dhe veprimtaritë e përditshme. Ne duhet të sigurohemi që të krijojmë, të përdorim në mënyrë të arsyeshme dhe të mbrojmë këtë informacion, veçanërisht për sa i përket të dhënave, siç janë të dhënat personale, informacioni tregtar sensitiv dhe pronësia intelektuale – qoftë tonat apo të të tjerëve. Duhet të kujdesemi për të mbrojtur informacionin konfidencial veçanërisht kur ndodhemi jashtë mjedisit të Shell. Gjithashtu, kemi për detyrë të sigurohemi që të mbajmë shënim të dhënat e veprimtarive tona të biznesit për të ruajtur memorien e korporatës dhe për të përmbushur kërkesat ligjore dhe rregullatore.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ▮ Duhet të vlerësoni rreziqet që lidhen me ndonjë informacion që ju keni në dispozicion, në mënyrë që të mund të menaxhoni siç duhet rreziqet dhe të mbronit të dhënat.
- ▮ Kur krijoni ose merrni informacion, duhet ta klasifikoni atë si konfidencial, ta deklaroni atë si të Dhënë nëse kërkohet, ta ruani në një vend të rezervuar të miratuar nga Grupi, dhe ta ndani vetëm me ata persona që kanë të drejtë dhe lejohen ta marrin atë, si dhe të respektoni kërkesat dhe materialet udhëzuese të hollësishme për Menaxhimin e Informacionit.
- ▮ Nëse punoni me palë të treta, duhet të siguroheni që jeni të autorizuar për të dhënë informacion përpara se ta bëni këtë gjë.
- ▮ Nëse keni marrë udhëzime nga Departamenti Juridik në Shell për ta ruajtur informacionin, duhet të siguroheni që ky informacion të ruhet sipas udhëzimeve.

QENDËR INFORMIMI



Kërkesat për menaxhimin e Informacionit mund t'i gjeni në <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/im>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Ne komunikojmë në të gjitha llojet e mënyrave - dhe, si staf i Shell, çdo gjë që shkruajmë apo themi pasqyrohet në reputacionin e Shell. Çfarëdo lloj mediash që të përdorni, brenda Shell ose jashtë tij, ne presim që nga ju të respektoni rregullat e Shell për nxjerrjen e informacionit dhe mbajtjen e komunikimeve të biznesit, duke përfshirë edhe rregullat e tjera që zbatohen për emailin dhe për mediat sociale.

Të gjitha komunikimet për publikun në emër të Shell janë objekt i kërkesave për nxjerrjen e informacionit dhe rrjedhimisht duhet të autorizohen nga Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, dhe në raste të veçanta nga Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Mediave dhe Marrëdhënieve me Investitorët. Duhet të përdoren deklaratat përkatëse për mosmbajtje përgjegjësie, sidomos kur komunikimi përmban informacion progresiv. Çdo komunikim për publikun në emër të Shell duhet të jetë i saktë në të gjitha aspektet materiale, i plotë, i përshtatshëm, i balancuar dhe në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Përveç kësaj, në mënyrë që çdo informacion i dhënë për publikun të mos konsiderohet aktual në vazhdimësi, ai duhet të përmbajë datën kur është dhënë ky informacion. Dhënia e informacionit të pasaktë, të paplotë, ose çorientues mund të jetë e jashtëligjshme dhe mund të çojë në vënien e gjobave, sanksioneve dhe dënimeve penale për Shell dhe për individët e përfshirë.

Ndalohet rreptësisht përdorimi i medias sociale personale për qëllime pune. Nëse një punonjës zgjedh të angazhohet ose jo në media sociale për qëllime personale kjo është një çështje personale dhe jo një vendim që ka lidhje me punën. Megjithatë veprimtaritë në median sociale që ndikojnë në performancën e punës së një punonjësi, në performancën e punonjësve të tjerë të Shell, apo në biznesin dhe reputacionin e Shell rregullohen nga ky Kod, pavarësisht nëse ato janë kryer ose jo përmes llogarisë personale në median sociale të punonjësit.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- Nuk duhet të jepni informacion për veprimtaritë e biznesit të Shell, nëse nuk jeni të autorizuar për ta bërë këtë. Kjo vlen për gjërat që thoni, si dhe për çdo gjë që komunikoni me shkrim.
- Nuk duhet të keni marrëdhënie me mediat në emër të Shell pa marrë lejen për dhënie e informacionit nga Departamenti i Shell për Marrëdhëniet me Median.
- Duhet të konsultoheni me Departamentin e Marrëdhënieve me Investitorët përpara se të angazhoheni me komunitetin e investimeve.
- Nëse pjesë e pozicionit tuaj punës është t'i jepni publikut dhe/ose komunitetin të investitorëve informacion rreth biznesit dhe financave të Shell, duke përfshirë edhe përmes medias sociale, duhet të siguroheni që të merrni autorizimin përkatës dhe që informacioni që do të jepni të jetë i vërtetë, i saktë, konsistent dhe jo çorientues. Duhet të respektoni të gjitha Standardet dhe Manualet përkatëse të Grupit dhe të siguroheni që të përdorni gjuhën e miratuar, në përputhje me Udhëzimin e Shell për Stilin, kur përdorni terma të tilla si "Shell" ose "Grup" dhe gjithmonë përdorni mjetin e duhur të komunikimit për mesazhin tuaj.

- ℞ Duhet të deklaroni se nga cila shoqëri e Shell vjen komunikimi dhe të përfshini të dhëna që kërkohen nga legjislacioni vendas, si dhe të dhënat tuaja të kontaktit (p.sh. nënshkrimin me të dhënat e kontaktit në emailin tuaj).
- ℞ Duhet të angazhoheni vetëm me një shoqëri të Shell nëse keni autoritetin korporativ për ta bërë dhe nuk duhet të nxirrni urdhra apo të merrni vendime për shoqëri për të cilat nuk punoni.
- ℞ Nuk duhet të përfshihen në biseda rastësore për çështje sensitive dhe konfidenciale apo të dërgoni komunikime që përmbajnë materiale të natyrës raciste, seksuale, fyese, shpifëse, mashtruese apo të papërshtatshme në ndonjë formë tjetër.
- ℞ Mund të përdorni kanale të medias sociale të miratuara vetëm nga Shell për përdorim biznesi nëse jeni përdorues i miratuar dhe nëse keni bërë trajnimet e nevojshme.
- ℞ Nuk duhet të përdorni llogari personale të medias sociale për dhënie të informacionit konfidencial të biznesit apo për qëllime të tjera biznesi.
- ℞ Nëse përdorni median sociale personale për qëllime personale për të diskutuar tema që lidhen me energjinë, ose për të miratuar apo për të dhënë dëshmi për Shell dhe për produktet/shërbimet e tij, duhet të deklaroni se:
 - jeni punonjës i Shell;
 - nuk po flisni në emër të Shell; dhe
 - këndvështrimet e shprehura janë tuajat dhe ato nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Shell.

QENDËR INFORMIMI



Manualin e Grupit për Nxjerrjen e Informacionit, të dhënat e kontaktit të Departamentit për Marrëdhëniet me Median dhe Marrëdhëniet me Investitorët, Standardet e Komunikimeve të Biznesit dhe Udhëzimet për Mediat Sociale mund t'i gjeni në <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/disclosureandbc>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

MENAXHIMI I RREZIKUT NË MARRËDHËNIET ME PALËT E TRETA DHE ATO NDËRKOMBËTARE

Sa herë që Shell negocion me një klient, partner biznesi, sipërmarrje të përbashkët, nëpunës shtetëror, konkurrent apo ndonjë palë tjetër të interesuar, duhet të kuptojmë rreziqet si dhe mundësitë. Gjithashtu, duhet të sigurohemi që marrëdhëniet ndërkufitare të Shell të jenë në përputhje me të gjithë legjislacionin përkatës tregtar.

Nëse nuk respektojmë ligjin, Shell mund të marrë gjoba ose biznesi ynë mund të dëmtohet rëndë. Edhe individët mund të përballen me gjoba ose burgim.

Ky seksion i Kodit tonë të Sjelljes është krijuar në mënyrë të tillë që marrëdhëniet tuaja të biznesit të mbeten të ligjshme, etike dhe profesionale, duke u siguruar që të mbron veten nga çdo dyshim për keqbërje dhe të ruani reputacionin e Shell.

Mos harroni - nëse mësoni ose dyshoni se dikush po shkel Kodin, jeni të lutur të flisni.

BRENDA KËTIJ SEKSIONI

5.1	Lufta kundër ryshfetit dhe korrupsionit	28
5.2	Dhuratat dhe mikpritja	29
5.3	Konfliktet e interesit	30
5.4	Lufta kundër pastrimit të parave	32
5.5	Veprimtaria politike dhe pagesat	33
5.6	Ligji i konkurrencës (antimonopol)	34
5.7	Përputhshmëria në tregti	35





ÇDO VEPRIM PA 100% PËRPUTSHMËRI DO TË MINONTE PERFORMANCËN TONË DHE MUND TË PËRFSHINTE KOSTO TË LARTA, TË CILAT DO TË DËMTONIN THEMELIN TONË SI DHE REPUTACIONIN QË KEMI FITUAR ME MUND... MOS LEJONI QË NGA MENDJELEHTËSIA TË RREZIKONI TË THYENI RREGULLAT DHE TË KRIJONI NJË RREZIK TË PAPANUESHËM."

Ben van Beurden, Drejtor i Përgjithshëm



5.1 LUFTA KUNDËR RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT

Ne në Shell i ndërtojmë marrëdhëniet bazuar në besim dhe jemi të vendosur për ta ruajtur dhe për ta rritur reputacionin tonë. Për këtë arsye ne nuk pranojmë apo japim kurrë ryshfete, duke përfshirë pagesa për lehtësira. Edhe pretendimet e pabazuara për ryshfet dhe korrupsion mund të dëmtojnë reputacionin e Shell.

Të gjithë ata që kanë lidhje me biznesin e Shell duhet të pajtohen me ligjet për luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit (ABC) të shteteve ku ne operojmë, si edhe me ligjet e zbatueshme përtej kufijve.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- Nuk duhet të ofroni, paguani, bëni, kërkoni ose pranoni një pagesë personale, dhuratë ose favor në këmbim të trajtimit të favorshëm ose për të marrë një përfitim biznesi. Nuk duhet t'ia lejoni askujt tjetër që ta bëjë diçka të tillë në emrin tuaj.
- Nuk duhet të bëni pagesa për lehtësira. Nëse ju është kërkuar ose është bërë një pagesë për lehtësira, ju duhet t'ia raportoni atë menjëherë menaxherit të linjës dhe Zyrës së Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell dhe Departamentit Juridik të Shell ose në linjën telefonike të ndihmës në të gjithë botën. Nëse bëni një pagesë sepse mendoni sinqerisht se rrezikohet rëndë siguria juaj ose liria juaj, kjo nuk quhet një pagesë për lehtësira, por duhet të raportohet sikur të ishte e tillë.
- Duhet të dini se me cilin po bëni biznes duke kryer një kontroll të kujdesshëm, siç përcaktohet në Ligjin për luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit dhe në manualin AML.
- Marrëdhëniet me Nëpunës Publikë ju përballin me një rrezik më të lartë për ryshfet ndaj duhet të ndiqni kërkesat e detyrueshme të ligjit për luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit dhe manualin AML.
- Ju duhet të raportoni sjelljet korruptive. Bërja e një syri qorr ndaj dyshimeve për ryshfet dhe korrupsion mund të sjellë përgjegjësi për Shell dhe për individët.

QENDËR INFORMIMI



Ligjin për luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit, Manualin AML, regjistrin e Kodit të Sjelljes, kontaktet për ligjin për luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit dhe më tepër detaje të programit për këtë ligj mund t'i gjeni në <http://sww.shell.com/ethicsandcompliance/abc>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Është e rëndësishme që të bëni gjënë e duhur dhe t'ju shohin teksa e bëni diçka të tillë. Për këtë arsye ne i kërkojmë personelit tonë që të mos pranojë dhurata dhe mikpritje nga partnerët e biznesit ose t'u ofrojnë atyre dhurata dhe mikpritje, veçanërisht dhurata dhe mikpritje për të cilat nuk do të donit që t'i tregonit menaxherit, kolegëve, pjesëtarëve të familjes ose publikut se ua keni ofruar të tjerëve ose i keni pranuar. Në veçanti ju nuk duhet të lejoni kurrë që dhuratat dhe mikpritja, qofshin të ofruara ose të marra, të ndikojnë në vendimet e biznesit ose t'i japin personave të tjerë një arsye për të dyshuar se mund të kenë pasur ndonjë ndikim të tillë. Ne ju nxisim që t'u bëni me dije politikën e Shell për dhuratat dhe mikpritjen agentëve dhe partnerëve tanë të biznesit, duke përfshirë qeveritë dhe Nëpunësit Publikë.

QENDËR INFORMIMI



Detajet për kufijtë e vlerave të dhuratave dhe mikpritjes, Formulën 1, regjistrin e Kodit të Sjelljes, Ligjin për luftën kundër rryshfetit dhe korrupsionit dhe Manualin AML, kontaktet për Ligjin për luftën kundër rryshfetit dhe korrupsionit dhe detaje të tjera të programit të këtij ligji dhe të Formulës 1 mund t'i gjeni në <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/gh>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

PËRGJEGJËSITË TUAJA

℞ Ju nuk duhet, as direkt as tërthorazi, të ofroni, të jepni, të kërkonit ose të pranoni:

- dhurata dhe mikpritje të paligjshme ose të papërshtatshme, para cash ose instrumente të barasvlershme me cash-in (duke përfshirë dieta ditore, përveçse kur është rënë dakord në mënyrë kontraktuale), automjete, shërbime personale ose hua në lidhje me biznesin e Shell; ose
- dhurata dhe mikpritje në mungesë të partnerit të biznesit, ose gjatë periudhave kur po merren vendime të rëndësishme biznesi; ose
- dhurata dhe mikpritje që tejkalojnë kufijtë e vlerave të parashikuara, përveçse kur është marrë miratimi i menaxherit të linjës ose miratime të tjera të nevojshme.

℞ Ju duhet të regjistroni në regjistrin e Kodit të Sjelljes: të gjitha dhuratat dhe mikpritjen që janë dhënë apo janë marrë, të cilat tejkalojnë kufijtë e vlerave të parashikuara për Nëpunësit Publikë ose palë të tjera të treat; çdo dhuratë dhe mikpritje që mund të perceptohet se ndikon në, ose krijon konflikt interesi dhe dhuratat e refuzuara në cash ose të një natyre të tepruar, duke përfshirë artikuj personale.

℞ Kur i ofroni dhurata dhe mikpritje një Nëpunësi Publik ju nuk duhet të ofroni ose të paguani për: ditët shtesë të udhëtimit drejt destinacioneve turistike ose vizitat private; pjesëtarët e familjes/të ftuarit (përveçse kur miratohet nga një ekspert i fushës në ligjin për luftën kundër rryshfetit dhe korrupsionit). Përpara se t'i ofroni ndonjë dhuratë dhe mikpritje një ëpunësi Publik kur vlera është më e madhe sesa kufijtë e vlerave të parashikuara, ju duhet të kërkonit paraprakisht miratimin nëpërmjet regjistrit të Kodit të Sjelljes.

℞ Përpara se të pranoni të merrni një çmim të fituar gjatë kryerjes së detyrës suaj, i cili i kalon kufijtë e vlerës së parashikuar, ju duhet të regjistroni detajet në regjistrin e Kodit të Sjelljes dhe të merrni miratimin e menaxherit tuaj të linjës.

Pyetje

Xhaxhai/daja im është zëvendës ministër i energjisë në vendin tim. A duhet ta deklaroj këtë në regjistrin e Kodit të Sjelljes?

Përgjigje

Ky mund të jetë një konflikt interesi i mundshëm, real ose i perceptuar, në varësi të pozicionit tuaj, biznesit të Shell në atë shtet të caktuar dhe të kushteve të tjera. Në të gjitha rastet, ju duhet ta deklaroni atë në regjistrin e Kodit të Sjelljes. Më pas menaxheri juaj i linjës mund të diskutojë me ju nëse duhet të ndërmerret ndonjë masë zbutëse për t'ju mbrojtur juve, Shell apo xhaxhanë/dajën tuaj.



Konfliktet e Interesit (Kel) mund të lindin kur marrëdhëniet tuaja personale, pjesëmarrja në veprimtari të jashtme ose një interes në një biznes tjetër, mund të ndikojë ose mund të perceptohet nga të tjerët se ndikon në vendimet tuaja të biznesit për Shell. Një Kel real, i mundshëm ose i perceptuar mund të rrezikojë reputacionin tuaj dhe të Shell. Ju duhet të shmangni, sa herë që është e mundur, Kel-t reale, të mundshme ose të perceptuara.

Nëse keni një Kel real, të mundshëm ose të perceptuar, duhet të mbronni veten nga çdo dyshim ose shpërdorim duke qenë transparent dhe duke i regjistruar detajet në regjistrin e Kodit të Sjelljes. Ky veprim kërkon vetëm pak minuta dhe mund t'ju shpëtojë nga shumë hetime që zgjasin në kohë.

Për sa kohë që nuk ka asnjë Kel real, i mundshëm ose i perceptuar, ju mund të përvetësoni interesa në biznese të tjera dhe të kryeni veprimtari profesionale të jashtme në kohën tuaj të lirë. Ju gjithashtu keni të drejtë që gjatë kohës së lirë, të angazhoheni në organizata komunitare, qeveritare, arsimore dhe organizata të tjera jofitimprurëse.

Megjithatë ju duhet të veproni në çdo rast në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe politikat e Shell. Nëse keni ndonjë shqetësim mund ta diskutoni me menaxherin tuaj të linjës ose Zyrën e Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell përpara se të nisni ndonjë veprimtari të re.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- B** Ju nuk duhet të lejoni që arsyet tuaja personale, si p.sh. marrëdhëniet ose interesat vetjake, familjare ose shoqërore të ndikojnë në vendimet që merrni në Shell.
- B** Të gjitha Kel-t reale, të mundshme ose të perceptuara duhet t'i regjistroni në regjistrin e Kodit të Sjelljes, edhe nëse mendoni se nuk do të ndikojnë realisht në vendimin tuaj.
- B** Kur nuk jeni i sigurt nëse ekziston një konflikt i tillë, duhet të konsultoheni me menaxherin e linjës, Zyrën e Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell ose Departamentin Juridik të Shell.
- B** Tërhiquni nga vendimmarrja që krijon një Kel real, të mundshëm ose të perceptuar, ose që mund të perceptohet se krijon një konflikt të tillë.

QENDËR INFORMIMI



Shembuj të Kel-ve, Ligjin për luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit, Manualin AML, regjistrin e Kodit të Sjelljes, kontaktet për Ligjin për luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit dhe më tepër detaje të programit për këtë ligj mund t'i gjeni në <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/coi>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

5.4 LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

Pastrimi i parave ndodh kur të ardhurat nga krimi fshihen në marrëveshje të ligjshme biznesi ose kur fondet e ligjshme përdoren për të mbështetur veprimtari kriminale, përfshi terrorizmin. Të gjitha shoqëritë rrezikojnë që të shfrytëzohen në këtë mënyrë dhe ne duhet të jemi vigjilentë për të mbrojtur reputacionin tonë dhe për t'u siguruar se veprimet në pajtim me legjislacionin tonë.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- ↳ Ju nuk duhet që me dijeninë tuaj të hyni në marrëveshje me kriminelë, kriminelë të dyshuar ose të përdorni të ardhura nga krimi.
- ↳ Ju duhet të plotësoni të gjitha kërkesat për kontrollin e kujdesshëm të specifikuar nga Shell në mënyrë që ta dimë se me kë po bëjmë biznes.
- ↳ Duhet të siguroheni se transaksionet tuaja të biznesit në emër të Shell nuk përfshijnë përfitimin, përdorimin ose mbajtjen e të ardhurave monetare ose të pasurive të përfituara nga veprimtari të kriminale.
- ↳ Ju nuk duhet ta fshihni origjinën ose natyrën e pasurisë kriminale.
- ↳ Ju nuk duhet ta lehtësoni përfitimin, marrjen në pronësi ose kontroll të pasurisë kriminale.
- ↳ Nëse jeni në dijeni ose dyshoni se një palë tjetër është e përfshirë në pastrim parash në lidhje me transaksionet e saj me Shell, duhet ta raportoni këtë menjëherë pranë Departamentit të Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell ose në linjën telefonike të ndihmës në të gjithë botën. Në mënyrë që të përmbushni kërkesat ligjore, mos lejoni që pala tjetër të marrë vesh dyshimet tuaja. Ju nuk duhet të falsifikoni, fshihni, shkatërmoni ose hidhni dokumente të rëndësishme.

QENDËR INFORMIMI



Ligjin për luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit dhe Manualin AML mund ta gjeni në <http://www.shell.com/ethicsandcompliance/aml>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

Jashtë punës ju të gjithë keni interesat tuaja dhe keni të drejtë të angazhoheni në veprimtari politike të ligjshme gjatë kohës suaj të lirë. Megjithatë, ne duhet gjithashtu që të mbrojmë interesat dhe reputacionin e Shell. Ndaj është e rëndësishme që individët t'i mbajnë të ndara veprimtaritë e tyre politike nga pozicioni që kanë në Shell.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- Nuk duhet të përdorni fondet ose burimet e Shell, qoftë direkt ose tërthorazi, për të ndihmuar në financimin e fushatave politike, partive politike, kandidatëve politikë ose kujtdo që ka lidhje me ta.
- Fondet e Shell nuk mund të përdoren për të mbështetur komitetet e veprimit politik (KVP). Burimet e shoqërisë, si p.sh. pajisjet e zyrës, emaili, fotokopjet dhe telefonat mund të përdoren vetëm në mbështetje të KVP-së për punëmarrësit e Shell.

- Nuk duhet të përdorni fondet e Shell për të bërë pagesa politike të maskuara si donacione bamirësie (shih gjithashtu ligjin për luftën kundër rryshfetit dhe korrupsionit dhe Manualin AML).
- Ju gjithmonë duhet të sqaroni se pikëpamjet politike që shprehni dhe veprimet që ndërmerrni janë personale dhe jo ato të Shell, përveçse kur ju kërkohet qartësisht që të përfaqësoni pikëpamjet e Shell si pjesë e pozicionit tuaj.
- Duhet të jeni në dijeni të rregullave për konfliktet e interesit dhe të garantoni se pjesëmarrja juaj në veprimtari të motivuara politikisht nuk ju përfshin ju ose Shell në një konflikt interesi.
- Nëse kandidoni për një post publik, ju duhet të konsultoheni dhe të merrni miratimin e menaxherit tuaj të linjës përpara se të hidhni kandidaturën. Ju gjithashtu duhet të deklaroni interesin tuaj në regjistrin e Kodit të Sjelljes dhe të veproni në pajtim me legjislacionin vendas që rregullon pjesëmarrjen politike.

QENDËR INFORMIMI



Më shumë informacione për veprimtarinë dhe pagesat politike, Ligjin për luftën kundër rryshfetit dhe korrupsionit dhe kërkesat e Manualit AML mund t'i gjeni në <http://sw.shell.com/ethicsandcompliance/politicalactivity>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

5.6 LIGJI I KONKURENCËS (ANTIMONOPOL)

Ligjet për konkurrencën mbrojnë sipërmarrjen e lirë dhe konkurrencën e ndershme. Mbështetja e këtyre parimeve është e rëndësishme për ne jo vetëm se kështu thotë ligji, por sepse ne besojmë te këto parime. Ne presim që personeli i Shell të luajë rolin e tij në luftën kundër praktikave të paligjshme. Këtu përfshihet fiksimi i çmimit, ndarja e tregut, kufizimi i produktit ose manipulimi i ofertave ose praktikant antikonkurrese ose monopoliste. Tregohuni vigjilentë që të mos bëheni pjesë e ndonjë bisede ose marrëveshjeje të papërshtatshme me konkurrentët tanë.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

- Nuk duhet të bini dakord me konkurrentët, qoftë dhe joformalisht, për të fiksuar çmimin ose ndonjë element të çmimit, si uljet e çmimit, mbitarifimet ose kushtet e kredisë.
- Ju nuk duhet të bini dakord me konkurrentët për të ulur ose stabilizuar prodhimin, kapacitetin ose produktin.
- Nuk duhet të bini dakord me konkurrentët për të ndarë klientë, llogari ose tregje të veçanta.
- Nuk duhet të manipuloni ofertat ose tenderat.
- Nuk duhet të bini dakord me të tjerët për të bojkotuar ndonjë klient ose furnitor përveçse në lidhje me sanksionet qeveritare të vendosura në nivel ndërkombëtar.

- Nuk duhet të përpiqeni që të vendosni një çmim minimal ose ndonjë çmim rishitjeje për një shitës, shpërndarës ose rishitës të pavarur.
- Nuk duhet të ndani ose të merrni informacione delikate për konkurrencën pa një arsye të ligjshme.
- Nuk duhet të diskutoni me konkurrentët asnjë çështje për të cilën konkurrentëve nuk u lejohej me ligj që të bien dakord.
- Ju duhet të ndiqni parimin se të gjitha vendimet në Shell për vendosjen e çmimit, prodhimin, klientët dhe tregjet duhet të merren vetëm nga Shell.
- Ju duhet të largoheni nga mbledhjet industriale ose aktivitete të tjera nëse aty ngrihen çështje delikate që lidhen me konkurrencën. Sigurohuni që largimi juaj të vihet re dhe menjëherë raportohet në këtë çështje tek Departamenti Juridik i Shell ose Departamenti i Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell.
- Ju duhet të flisni nëse jeni në dijeni të ndonjë praktike që mund të jetë antikonkurrese ose nëse nuk jeni të sigurt nëse këto praktika janë ose jo të ligjshme.

QENDËR INFORMIMI



Manualin për konkurrencën, rregullat për konkurrencën, politikën për mbrojtje të Shell dhe kontaktet për ligjin për konkurrencën mund t'i gjeni në <http://sww.shell.com/ethicsandcompliance/at>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

5.7 Përputhshmëria në tregti

Njësoj si të gjitha kompanitë e tjera mbarëbotërore ne duhet të respektojmë të gjitha rregulloret e përputhshmërisë në fushën e tregtisë të zbatueshme në nivel kombëtar ose ndërkombëtar. Përputhshmëria në fushën e tregtisë përfshin rregulloret që rregullojnë importin, eksportin dhe tregtinë e brendshme të mallrave, teknologjinë, softuerët dhe shërbimet si dhe sanksionet ndërkombëtare dhe praktikat tregtare kufizuese.

Papajtueshmëria me ligjet e zbatueshme mund të çojë në gjoba, vonesa, konfiskim të mallrave ose humbje të privilegjeve të Shell në eksport ose import, si edhe në dëmtimin e reputacionit të Shell ose burgosjen e individëve. Është shumë e rëndësishme që ju të jeni në dijeni të kërkesave dhe mënyrës se si ato zbatohen në pozicionin që ju mbani. Duke e bërë diçka të tillë ju ndihmoni shoqërinë që të vazhdojë të bëjë biznes në nivel ndërkombëtar.

PËRGJEGJËSITË TUAJA

Ju duhet të merrni, të mbani dhe komunikoni klasifikimin e saktë doganor dhe të kontrollit të eksportit për të gjitha mallrat dhe softuerët që lëvizin në nivel ndërkombëtar. Për lëvizjet fizike të mallrave dhe softuerëve kërkohet edhe vlerësimi dhe informacioni për origjinën e tyre.

- ↳ Kur udhëtoni me pajisje dhe harduerë që janë në pronësi të qeverisë, duke përfshirë kompjuterët laptop, telefonat inteligjentë dhe pajisje të tjera komunikimi, duhet të ndiqni udhëzimin e shoqërisë.
- ↳ Kur përdorni shërbimet e agjentëve tregtar/klientëve duhet të ndiqni procedurat e shoqërisë.
- ↳ Kur lëshoni ose nënshkruani Certifikatën e Përdoruesit Fundor duhet të ndiqni procedurat e shoqërisë.
- ↳ Duhet të siguroheni se palët e treta me të cilat bashkëpunoni janë verifikuar sipas listave të sanksioneve të zbatueshme.
- ↳ Kur bashkëpunimet tuaja me një palë të tretë zbulojnë fakte të dyshimta ose “alarmante”, duhet të ndaloni këtë veprimtari dhe të kërkonti ndihmë nga një menaxher për kontrollin e tregtisë.
- ↳ Ju nuk duhet të kryeni veprimtari në një vend ose me një palë kundër të cilëve janë vendosur sanksione, përveçse kur autorizohen specifikiisht në përputhje me procedurat e shoqërisë. Nëse jeni të autorizuar të kryeni veprimtari në një shtet kundër të cilit janë vendosur sanksione ose me një palë kundër së cilës janë vendosur kufizime ose sanksione, duhet të respektoni me rigorozitet udhëzimet e shoqërisë.
- ↳ Gjatë prodhimit, shitjes, eksportimit ose importimit të artikujve ushtarakë, të mbrojtjes ose që lidhen me drogën, duhet të këshilloheni me dhe të merrni mbështetjen e menaxherit tuaj për kontrollin e tregtisë.
- ↳ Teknologjinë e kontrolluar duhet ta klasifikoni, etiketoni dhe trajtoni në përputhje me procedurat e shoqërisë.
- ↳ Kur përballeni me një kërkesë për tregti të kufizuar duhet të ndaloni veprimtarinë dhe të këshilloheni me një këshilltar ligjor për kontrollin e tregtisë.

QENDËR INFORMIMI



Manualin për kontrollin e tregtisë, procedurat dhe udhëzimet për kontrollin e tregtisë dhe rastet alarmante mund t'i gjeni në <http://sw.shell.com/ethicsandcompliance/tc>

Raporto një shqetësim – Linja telefonike e ndihmës në të gjithë botën (<https://shell.alertline.eu/>)

FALEMINDERIT PËR KOHËN QË I KUSHTUAT LEXIMIT TË KODIT TONË TË SJELLJES. KY KOD DO T'JU NDIHMOJË TË KUPTONI RREZIQTË KRYESORE PËR JU DHE PËR SHELL DHE SE SI MUND TË RUANI REPUTACIONIN E SHELL DUKE NJOHUR DHE DUKE KUPTUAR PËRGJEGJËSITË TUAJA.

Sigurisht që Kodi nuk mund të mbulojë çdo situatë ndaj kurdo që nuk jeni të sigurt se si të veproni, kërkoni këshillën e dikujt. Kontaktoni me menaxherin tuaj të linjës, Zyrën e Etikës dhe Përputhshmërisë në Shell, Burimet Njerëzore, Departamentin Juridik të Shell ose kontaktoni me linjën telefonike të ndihmës në të gjithë botën. Kjo është e rëndësishme veçanërisht kur dyshoni se dikush po shkel Kodin dhe po e vendos Shell në rrezik. Në këtë rast, ju e keni për detyrë të flisni.

Ne shpresojmë që ju t'i referoheni Kodit sa herë që ka ndryshime në pozicionin tuaj, kur ju përballeni me një dilemë të re, ose kur thjesht ju nevojitet që të rifreskoni kujtesën. Mbi të gjitha ne duam që ju të respektoni Kodin çdo ditë dhe të siguroheni që të merrni gjithmonë vendime të drejta.

DONACIONET PËR BAMIRËSI

Çdo gjë me vlerë që i jepet një organizate bamirëse; ose një sponsorizim që jepet pa pagesë për bamirësi; ose çdo shpenzim për zhvillimin e komunitetit.

INFORMACION SENSITIV NË LIDHJE ME KONKURRENCËN

Çdo informacion që mund të ndikojë në sjelljen e tregut, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, informacionin në lidhje me shitjet, çmimet, negocimet e kontratës, përdorimin e kapacitetit, prodhimin.

PERSONELI I KONTRAKTUAR

Personel që ofron shërbime nën mbikëqyrjen e përditshme të Shell, i cili nuk ka marrëdhënie kontraktuale direkte me Shell por është i punësuar dhe paguhet nga një shoqëri e jashtme.

KONTRAKTORË DHE/OSE KONSULENTË

Një term i përgjithshëm për një individ ose një firmë që ka lidhur kontratë për të ofruar mallra dhe/ose shërbime për një shoqëri të Shell.

TEKNOLOGJI E KONTROLLUAR

Artikuj të identifikuar me anë të një numri specifik klasifikimi për kontrollin e eksportit (ECCN) ose një listë tjetër zyrtare e qeverisë për artikujt e kontrolluar. Mallrat, teknologjitë, softuerët ose shërbimet e kontrolluara mund të kërkojnë autorizim ose licencë nga qeveria përpara se të eksportohen ose importohen drejt palëve ose destinacioneve të caktuara.

PAGESË PËR LEHTËSIRA

Një pagesë e vogël për të nxitur një Nëpunës Publik (zakonisht të nivelit të ulët) që të përshpejtojë ose të garantojë kryerjen e një detyre rutinë të cilën ai person është i detyruar të kryejë dhe kur kjo pagesë do të tejkalonte pagesën e zakonshme për këtë shërbim.

DHURATAT DHE MIKPRITJA

Përfshin (por nuk kufizohet me) dhuratat, udhëtimin, akomodimin, udhëtimet, shërbimet, zbavitjen, çmimet nga konkurse të jashtme ose lotari ose çdo artikull, aktivitet, përfitim ose diçka tjetër me vlerë që merret nga ose i ofrohet pa pagesë çdo personi, në lidhje me biznesin e Shell.

NËPUNËS PUBLIK

Punëmarrës i çdo qeverie (vendore apo qendrore); ose i një shoqërie të kontrolluar plotësisht ose pjesërisht nga shteti; ose një zyrtar i një partie politike; ose punëmarrës i një organizate ndërkombëtare; ose pjesëtar i afërt i familjes së çdokujt prej këtyre.

PRONËSI INTELEKTUALE

Përfshin të drejtat e patentës; modelet e përdorimit; markat tregtare dhe markat e shërbimit; emrat e domenit; të drejtën e autorit (duke përfshirë të drejtën e autorit për softuerë); të drejtat e dizenjot; të drejtat për ekstraktin e bazës së të dhënave; të drejtat për metodat dhe informacione të tjera konfidenciale (ndonjëherë të quajtura “sekret tregtar” ose “informacion pronësor”); dhe të drejtat në zbatim të marrëveshjeve që lidhen me pronësinë intelektuale.

TË DHËNA

Një nëngrup informacionesh i krijuar ose i marrë si provë e veprimtarisë së biznesit ose që kërkohet për qëllime ligjore, tatimore, rregullatore ose kontabiliteti, ose me rëndësi për biznesin e Grupit Shell ose memorien organizative. Të dhënat mund të ekzistojnë në formë shkresore, si dokumente fizike apo imazhe ose mund të ruhen në format elektronik të lexueshëm ose të dëgjueshëm.

SHOQËRI E SHELL

Çdo shoqëri në të cilën Royal Dutch Shell plc zotëron një interes kontrollues, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Kjo përfshin shoqëritë holding, shoqëritë e shërbimit dhe shoqëritë operuese.

SME

Ekspert i fushës.

6.2 PARIMET E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT TË SHELL

PARIMI 1: EKONOMIK

Përfitim i afatgjatë është thelbësor për të arritur objektivat tona të biznesit dhe për rritjen tonë të vazhdueshme. Ai shërben si matës i efikasitetit dhe vlerës që klientët u japin produkteve dhe shërbimeve të Shell. Siguron burimet e nevojshme të korporatës për investimet e vazhdueshme, të nevojshme për të zhvilluar dhe prodhuar furnizimet e ardhshme me energji për të përmbushur nevojat e klientëve. Pa fitime dhe pa një bazë të fortë financiare do ta kishim të pamundur që të përmbushnim përgjegjësitë tona. Kriteret për vendimet për të kryer investime ose për t'i tërhequr ato përfshijnë faktorët për zhvillimin e qëndrueshëm (ekonomik, social dhe mjedisor) dhe një vlerësim të rreziqeve të investimit.

PARIMI 2: KONKURRENCA

Shoqëritë e Shell mbështesin sipërmarrjen e lirë. Ne kërkojmë të konkurrojmë me ndershmeri dhe etikë, dhe brenda kuadrit të ligjeve të zbatueshme për konkurrencën; ne nuk i ndalojmë të tjerët që të konkurrojnë lirisht me ne.

PARIMI 3: INTEGRITETI I BIZNESIT

Shoqëritë e Shell i mësojnë ndershmërisë, integritetit dhe drejtësisë në të gjitha aspektet e ushtrimit të aktivitetit dhe presim të njëjtën gjë në marrëdhëniet me palët me të cilat bëjmë biznes. Oferta, pagesa, kërkesa ose pranimi drejtpërdrejt ose tërthorazi i ryshfeteve të çdo forme është i papranueshëm.

Edhe pagesat për lehtësira janë ryshfete dhe nuk duhet të kryhen. Punonjësit duhet të shmangin konfliktet e interesit midis veprimtarive të tyre private dhe rolit që luajnë në ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë. Punonjësit duhet të deklarojnë pranë shoqërisë që i ka punësuar konfliktet e mundshme të interesit. Të gjitha transaksionet e biznesit që kryhen në emër të një shoqërie të Shell duhet të pasqyrohen me saktësi dhe ndershmeri në regjistrat kontabël të shoqërisë, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe të jenë objekt auditimi dhe publikimi.

PARIMI 4: VEPRIMTARITË POLITIKE

A. Të shoqërive
Shoqëritë e Shell sillen me përgjegjësi sociale sipas legjisllacionit të shteteve ku operojnë, në arritjen e objektivave tregtare legjitime.

Shoqëritë e Shell nuk bëjnë pagesa për parti politike, organizata politike ose përfaqësues të tyre. Shoqëritë e Shell nuk bëhen pjesë e partive politike. Megjithatë, gjatë bashkëpunimeve me qeveri të ndryshme shoqëritë e Shell kanë të drejtën dhe përgjegjësinë që të shprehin qëndrimin e tyre ndaj çdo çështjeje që na prek ne, punonjësit tanë, klientët tanë, aksionarët tanë ose komunitetet lokale, në një mënyrë që përputhet me vlerat tona themelore dhe parimet tona të biznesit.

B. Të punonjësve

Kur individët dëshirojnë të angazhohen në veprimtari të ndryshme në komunitet, duke përfshirë kandidimin për t'u zgjedhur në një post publik, atyre do t'u jepet mundësia ta bëjnë diçka të tillë, kur kjo është e përshtatshme në rrethanat lokale.

PARIMI 5: SHËNDETI, SIGURIA, MBROJTJA DHE MJEDISI

Shoqëritë e Shell kanë një qasje sistematike ndaj menaxhimit të shëndetit, sigurisë, mbrojtjes dhe mjedisit për të arritur një përmirësim të vazhdueshëm të performancës.

Për këtë qëllim, shoqëritë e Shell i menaxhojnë këto çështje si veprimtari biznesi kritike, vendosin standarde dhe objektiva për t'u përmirësuar dhe matin, vlerësojnë dhe raportojnë performancën nga jashtë. Ne vazhdimisht kërkojmë mënyra për të ulur ndikimin mjedisor të veprimtarive, produkteve dhe shërbimeve tona.

PARIMI 6: KOMUNITETET LOKALE

Shoqëritë e Shell synojnë të jenë fqinjë të mirë, duke përmirësuar vazhdimisht mënyrat sipas të cilave ne kontribuojmë drejtpërdrejt ose tërthorazi në mirëqenien e përgjithshme të komuniteteve brenda të cilave ne punojnë.

Ne i menaxhojmë me kujdes ndikimet sociale të veprimtarive tona të biznesit dhe punojmë me të tjerët për të shtuar përfitimet për komunitetet lokale dhe për të zbutur çdo ndikim negativ nga veprimtaritë tona. Gjithashtu shoqëritë e Shell kanë një interes konstruktiv në çështjet shoqërore që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me biznesin tonë.

PARIMI 7: KOMUNIKIMI DHE PËRKUSHTIMI

Shoqëritë e Shell e pranojnë se dialogu dhe angazhimi i rregullt me aksionarët tanë është thelbësor. Në zbatim të çdo faktori thelbësor të konfidencialitetit të biznesit, ne jemi të përkushtuar për të raportuar për performancën tonë duke u dhënë informacionin përkatës dhe të plotë palëve të interesuara me të drejtë.

Gjatë marrëdhënieve tona me punonjësit, partnerët e biznesit dhe komunitetet lokale ne kërkojmë t'i dëgjojmë dhe t'u përgjigjemi atyre me sinqeritet dhe përgjegjshmëri.

PARIMI 8: PËRPUTHSHMËRIA

Ne veprojmë në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në shtetet ku operojmë.



© 2015 Shell International Limited

Botuar në nëntor 2015

Për të riprodhuar ndonjë pjesë të këtij botimi duhet të merret leje nga Shell International Limited.
Leja zakonisht jepet, por me kusht që të citohet burimi.

Nëse ka mospërputhje ndërmjet versionit të përkthyer dhe versionit në gjuhën angleze, versioni në gjuhën angleze ka përparësi.

Shtypur nga Charterhouse Print Management.
Letra e përdorur është Amadeus Silk (100% e ricikluar)

Printeri dhe fabrika e letrës janë të certifikuar nga FSC.